



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonomë dhe Financat

Tiranë, më 28.01.2025
Dokument parlamentar
(Komision përgjegjës)

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.29/2023, "PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datës 22.1.2025 dhe 28.1.2025, mori në shqyrtim projektligjin "Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar", propozuar nga deputeti Z. Blendi Klosi, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Enslemvera Zake.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin ishte i pranishëm Z. Blendi Klosi me cilësinë e propozuesit, ndërsa në emër të qeverisë ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave Znj. Arjana Dyrmishi Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave Tatimore dhe Znj. Zarina Taja, Drejtoreshë e Tatimeve Direkte.

II. Baza ligjore Kushtetuese.

A. Baza kushtetuese dhe ligjore e projektligjit.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një deputete, bazuar në përcaktimet e nenit 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- Nga ana *juridike procedurale*, projektligji i nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 78, 81 pika 1 dhe nenin 83, pika 1 dhe nenit 155, të Kushtetutës.

- Në aspektin juridik formal-procedural, akti shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68, pika 2 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit

B. Vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas e ndërkombëtar.

- Në aspektin kushtetues, vlerësohet se projektligji respekton principet kryesore kushtetuese dhe kryesisht: parimin e sigurisë juridike, respekton parimet e sistemit ekonomik në RSH bazuar në pronën private, në ekonominë e tregut si dhe në të drejtat dhe liritë e veprimtarisë ekonomike (nenin 11 të Kushtetutës), respekton parimin e barazisë para ligjit (neni 18) pasi krijon një kategori të veçantë bazuar në kritere objektive

- Në vlerësimin e aspektit ligjor, gjerësisht se projektligji harmonizohet me: ligjin nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" përjashtimi ekziston aktualisht por shtohen elementë specifik përfitues dhe lehtësish fiskale, me legjislacionin e turizmit për sa i përket klasifikimit të strukturave akomoduese, me ligjin për pronësinë industriale lidhur me markat tregtare si dhe me kuadrin ligjor për nxitjen e investimeve strategjike.

- Në vlerësim të respektimit dhe zbatimit të së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane, akti i propozuar nuk mundëson një përafrim me ndonjë *acquis* por synon harmonizim të politikave fiskale në turizëm me vendet e rajonit e më gjerë për ta bërë turizmin Shqiptar sa më të konkurrueshëm.

Për sa më sipër, konkludojmë se projektakti është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, respekton parimet dhe të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane.

III. Qëllimi, objektivat, dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi

Projektligji synon të krijojë një instrument fiskal të qënësishëm për nxitjen e investimeve të huaja në sektorin e turizmit elitari në Shqipëri. Projektligji synon vijimin e përjashtimit nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10-vjeçare për strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special" që operojnë nën një markë ndërkombëtare të njohur dhe që kanë fituar statusin special sipas legjislacionit në fuqi deri në vitin 2026.

Sipas propozimit efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.

Kjo iniciativë në kuadër të turizmit vjen për shkak se ai përfaqëson një nga sektorët më strategjikë të ekonomisë shqiptare, me një kontribut të konsiderueshëm në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe punësim.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka shënuar një rritje të qëndrueshme në numrin e vizitorëve ndërkombëtarë, duke u shndërruar në një destinacion gjithnjë e më tërheqës në rajonin e Mesdheut.

Projektligji në respektim të nenit 82, pika 2, në kushtet kur shoqërohet me pakësim të të ardhurave, përmes shkresës nr.4698/1, datë 26.12.2024, i është dërguar për mendim Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave pasi ka marrë edhe mendimin e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit me vendim vlerëson pozitivisht iniciativën për këtë projektligj duke bërë edhe sugjerimet përkatëse.

Përmbajtja e Projektligjit

Projektligji përbëhet nga 2 nene gjithsej

- Në nenin 1 të projektligjit propozohet që "e) Entitetet që operojnë në struktura akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name", përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10 vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026.

Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special".

- Në nenin 2 të projektligjit, përcaktohet hyrja e tij në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire

Projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të Be-së.

V. Ndikimi i projektligjit në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Agjenda 2030).

Në kuadër të angazhimit të Qeverisë Shqiptare në vijimin e planeve dhe projekteve për t'i bërë realitet Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (Axeenda 2030), vlerësohet se projektligji

“Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar”, lidhet me disa prej këtyre objektivave dhe konkretisht:

- **Objektivi 8 (Punë e denjë dhe rritje ekonomike).** Projektligji ndikon drejtpërdrejt në këtë objektiv duke: Promovuar rritjen ekonomike të qëndrueshme përmes investimeve në sektorin e turizmit; Krijuar vende të reja pune në strukturat akomoduese elitare; Nxitur formalizimin e ekonomisë përmes tërheqjes së brandeve ndërkombëtare; dhe Përmirësuar kushtet e punës dhe standardet profesionale në sektorin e turizmit.
- **Objektivi 12 (Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm).** Projektligji kontribuon në: Promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën lokale; Inkurajimin e kompanive, veçanërisht atyre të mëdha dhe ndërkombëtare, të adoptojnë praktika të qëndrueshme; Zhvillimin e infrastrukturës turistike sipas standardeve ndërkombëtare të qëndrueshmërisë.
- **Objektivi 17 (Partneritete për objektivat).** Projektligji ndikon në: Tërheqjen e investimeve të huaja direkte në sektorin e turizmit; Forcimin e partneriteteve ndërkombëtare përmes prezencës së brandeve globale; Transferimin e njohurive dhe teknologjisë në sektorin e turizmit

Gjithashtu, në mënyrë indirekte projektligji kontribuon në:

- **Objektivi 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme).** Projektligji do ketë impakt në: Përmirësimin e infrastrukturës turistike; Zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rajonal; Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- **Objektivi 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë).** Projektligji do të ketë impakt në: Modernizimin e infrastrukturës turistike; Nxitjen e inovacionit në sektorin e shërbimeve; Rritjen e standardeve të cilësisë në industrinë e turizmit.

VI. Konsultimi publik

Kuvendi nuk ka zhvilluar konsultim publik për këtë projektligj.

VII. Institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e projektaktit

Zbatimi i projektligjit do të koordinohet nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. Efektet financiare të projektligjit

Projektligji ka efekte financiare shtesë në buxhetit e shtetit, por këto efekte nuk janë përcaktuar në relacion dhe ka vështirësi për tu përlogaritur për shkak të pamundësisë për të njohur listën e përfituesve sipas këtij ligji.

IX. Shqyrtimi i projektligjit në komision:

Propozuesi i nismës Z. Klosi u shpreh se vjen në këtë komision me këtë propozim për herë të dytë. Në 2019 në cilësinë e ministrit për Turizmin bëra propozimin për herë të parë duke vlerësuar rëndësinë e turizmit dhe rëndësinë e të bërit emër me hotelet brand name, dhe është nga ato ndërhyrje që realisht sjellin një ndryshim të jashtëzakonshëm në industrinë përkatëse. Sot falë kësaj politike kemi 11 brand-e të regjistruara në vendin tonë me këtë kapacitet dhe gjithashtu falë këtij ndryshimi kemi rreth 11 të tjerë të cilët janë futur dhe janë në proces zhvillimi, pra sot në Shqipëri kemi 22 brand-e nga më të pëlqyerit në industrinë e turizmit, të cilët falë këtij ndryshimi kanë realizuar investimet e tyre në Shqipëri.

Këto hotele me 4 dhe 5 yje (kryesisht me 5 yje) kanë sjelle si kapital të investuar në Shqipëri rreth 450 milion euro nga të cilat 100 milion janë aktive tashmë.

Vijmë përsëri me këtë projektligj, pasi në vitin 2019 nuk kishte asnjë brand në sektorin e turizmit Shqiptar, në të gjithë hapësirat për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Kështu në 2019 kur filloi ky proces bashke me iniciativën turizmi kishte një lloj hovi të konsiderueshëm por filloi pandemia, e cila u pasua edhe nga luftëra (2020-2022) të cilat sollën rritjen e inflacionit çfarë bëri që këto investime thuajse të tëra u ndërprejnë dhe realisht periudha ka qenë shumë e vështirë për industrinë e turizmit. Aktualisht interesi për këto investime është shumë i shtuar. Duhet theksuar fakti se të gjitha këto investime bëhen në vendet ku ka interes të shtuar turistik, pra bëhen në zonat me përparësi zhvillimi të turizmit, përcaktuar nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, pra në përgjithësi janë jashtë qendrave të banuara jo në Tiranë dhe në qytetet kryesore.

Nisma ka për qëllim të përjashtojë nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës entitetet që operojnë në struktura akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name", përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10-vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special. Pra kërkohet shtimi edhe me 2 vjet i të drejtës së përjashtimit për këto struktura (ishte deri në 2024) nga momenti që jemi deri në 2026.

Projektligj synon incentivimin e sektorit te turizmit duke ulur normën tatimore në 0% për 10 vitet e para fiskale, për strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës së turizmit.

Z. Klodi sqaroi që Qeveria ka propozuar që ky afat 3 vjecar i propozuar prej ti, të zgjatet në 5 vjet pasi ka rezultuar se periudha për aplikimin apo zbardhjen e lejes së ndërtimit ka qenë më e madhe se 3 vjet, duke tejkaluar afatin e vendosur për të realizuar investimin. Ndërkohë, në disa prej aplikimeve të fundit, projektet e propozuara, për shkak të përmasave të mëdha të investimeve, kanë pasur afat realizimi dukshëm më të madh se afati i vendosur 3-vjeçar.

Këto brand-e zhvillohen në vende jo urbane dhe asnjë prej tyre nuk është zhvilluar në qytetin e Tiranës, por në zonat e reja që kërkojnë studime urbanistike dhe të zhvillimit të infrastrukturës.

Si çdo industri tjetër dhe ajo e turizmit ka nevojë që të ketë standartet e larta mbi të cilat duhet të zhvillohet industria turistike. Hotelet me 5 yje janë një risi, dhe kërkojnë, hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e numrit të turistëve dhe vizitorëve me potencial të madh të fuqisë blerëse që do të qëndrojnë në Shqipëri, rritjen e konsumit si një faktor të rëndësishëm në rritjen e GDP-së.

Duke përfunduar Z. Klosi theksoi se kur ne ndërtoam këtë strategji dhe kur përcaktuar këto lehtësira fiskale pretenduam të kishim një paketë pak më pozitive se gjithë vendet e rajonit sidomos ato të Ballkanit Perëndimor por këtu përfshihet edhe Turqia, të cilat kanë bërë të tillë lehtësira fiskale pasi kërkesa për të thirrur brand-e dhe marka në territorin e tyre është një konkurrencë e madhe në fushën e turizmit

Relatorja e komisionit në fjalën e saj evidentoi qëllimin dhe rëndësinë e projektligjit, si dhe theksoi kushtetutshmërinë dhe përputhshmërinë e tij me legjislacionin në fuqi.

Relatorja evidentoi faktin se arritjet e deritanishme në sektorin e turizmit shqiptar përfshijnë:

Rritjen e ndjeshme të numrit të turistëve ndërkombëtarë; Përmirësimin e infrastrukturës turistike; Diversifikimin e produktit turistik; Rritjen e të ardhurave nga turizmi; Përmirësimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik.

Pavarësisht arritjeve të sipërcituara, turizmi shqiptar përballet aktualisht me sfida konkurruese në raport me vendet fqinje, veçanërisht në aspektin e cilësisë së strukturave akomoduese.

Projektligji adreson pikërisht këtë problematikë dhe synon të tërheqë investime cilësore në sektorin e turizmit duke ofruar përjashtime nga tatimi mbi të ardhurat korporatave për strukturat akomoduese të kategorisë së lartë. Kjo masë pritet të ketë disa efekte pozitive:

- Në aspektin ekonomik: projektligji do të nxisë investimet e huaja direkte në sektorin e turizmit, duke sjellë në vend marka ndërkombëtare prestigjioze dhe duke rritur standardet e shërbimit turistik; do sjellë zgjerimin e bazës së taksapaguesve në periudhën afatgjatë si dhe rritje të GDP-së përmes rritjes së konsumit.

- Në aspektin social, krijimi i strukturave akomoduese të nivelit të lartë do të gjenerojë vende të reja pune dhe do të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit në sektor përmes transferimit të njohurive dhe praktikave më të mira ndërkombëtare si dhe përmirësim i standardeve të shërbimit.
- Në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm, prezenca e markave ndërkombëtare do të ndihmojë në promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik cilësor; do kontribuojë në zgjatjen e sezonit turistik; Rritje e numrit të turistëve me potencial të lartë blerjeje si dhe diversifikim të ofertës turistike.

Siç propozuesi ka evidentuar në relacionin shoqërues të projektligjit iniciativa ndjek një trend rajonal të incentivave fiskale në turizëm si Serbia e cila ofron përjashtim 10-vjeçar nga tatimfitimi për investime mbi 8 milionë euro që gjenerojnë minimum 100 vende pune.

Ndërkohë Turqia e cila është lider në turizëm aplikon reduktim deri në 90% të tatimit mbi fitimin dhe të ardhurat personale për një periudhë deri në 10 vjet për investimet në turizëm.

Padyshim ky projektligj është vijim i një sërë incentivash të marra nga qeveria Shqiptare me fokus turizmin.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, shpjeguan që janë njohur me nismën dhe kanë dhënë mendim pozitiv lidhur. Në bazë të të dhënave të siguruara nga Administrata tatimore rezulton që kanë ardhur disa brand name që operojnë në këtë sektor si rezultat i kësaj lehtësie si Mariot, Radison Collection, Hyjat Regensy etj. Për vitin 2023 ka patur një qarkullim rreth 5.2 miliard lekë vetëm nga këto kompani dhe janë çelur rreth 888 vende të reja pune të hapura po nga këto kompani. Bazuar edhe në eksperiencat me vendet e tjera ku sektorë të ndryshëm të ekonomisë me qëllim rritjen dhe konsolidimin e tyre trajtohen edhe me incentiva fiskale na rezulton që edhe vende të tjera fqinje si Greqia, Mali i Zi, Kroacia aplikojnë thuajse në të njëjtën linjë lehtësirat fiskale. Për këto arsye kemi dhënë mendimin tone pozitiv lidhur me këtë propozim.

Anëtarët e komisionit ngritën pyetje të ndryshme për propozuesin dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të cilat shkurtimisht konsistonin në:

- Sqarimin nëse këto lehtësira fiskale aplikohen apo jo në operatorët brand name dhe me markë të regjistruar edhe në qytetin e Tiranës apo dhe në qytetet të tjera.
- Sa subjekte kanë përfituar nga kjo lehtësi fiskale/privilegj?;
- Sa është fitimi i deklaruar i kompanive që e kanë përfituar këtë privilegj sipas deklarimit?
- Sa projekte janë në proces dhe sa kërkesa të tjera ka në shqyrtim e sipër?

Lidhur me këto çështje, propozuesi dhe Ministristria e Financave shpjeguan se:

Politikat e turizmit janë politika që ndihmojnë të gjithë ekonominë shqiptare, që kanë sjellë mbi 10 milion turist të huaj në vit, kapitali tejet i konsiderueshëm i investuar në këto biznese influencon jo vetëm ndërtesat e këtyre strukturave por shumë e shumë biznese të tjera në Shqipëri si, fermerët që shesin prodhimet e tyre, bizneset që mbajnë plazhet, bizneset që

furnizojnë me lëndë të parë, ato që punojnë nëpër këto hotele dhe të gjithë ata që merren me industrinë e turizmit. Pra nuk jemi përpara një politike sektoriale por një politikë e cila kërkon të thithë në Shqipëri ajkën e hotelerisë botërore. Marrja e titullim brand name kërkon plotësimin e disa kushtëzimeve si pasjen e të paktën 3 hoteleve me këtë emër në Bashkimin Europian apo 7 në të gjithë rruzullin tokësor.

Këtë status e marrin projektet e reja, jo ato të cilat tashmë janë të ndërtuara. Hotelet Marriott, Plaza etj hotele në Tiranë nuk e kanë përfituar këtë status pasi së pari nuk janë investime të reja dhe së dyti nuk janë hotele të ndërtuara në zonat me përparësi zhvillimi të turizmit. Përfitojnë nga statusi hotelet e reja, të lidhura me një brand dhe është ky i fundit që dikton ruajtjen e standarteve të brandit dhe cilësi. Duhet të kihet në konsideratë fakti që bëhet fjalë për hotele mbi 200 dhoma dhe jo hotele me 10-20 dhoma. P.sh. Melia ka 360 Hotele në botë dhe atë hotel që ka në Shqipëri e ka me të njëjtën standart me atë që ka nëpër botë.

Aktualisht, kanë lidhur kontratat me Qeverinë Shqiptare 11 subjekte, të cilat nuk janë në zona urbane por në zonat me përparësi turizmin, disa prej tyre janë tashmë janë operativ, sic është psh. Zona e Rinasit ku operon edhe M.K. Hotel që është hoteli i parë që ka marrë këtë status në Shqipëri, Melia Resort Hotel është në Gjirin e Lalëzit, Grand Melia në Zonën e Dhërmiut, Radisson Hotel Premium dhe Radisson Collection Hotel që janë në zonën e Himarës, Mk Gallery Accor Group në zonën e jugut Hyatt Regency Resort & Spa hotel në zonën e Palasës, Crown Plaza në jug.

Fitimi i tatueshëm për vitin 2023 në total është 518 milion lekë (për 10 kontrata), totali i numrit të të punësuarve është 888 punonjës me TVSH të paguar në 2023 në masën 77 milion lekë.

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, shqyrtoi edhe raportin e Komisionit për Çështjet Europiane dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i cili e ka shqyrtuar projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, dhe nuk ka ndonje sugjerim konkret.

X. Përfundime

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi si dhe duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të nxisë investimet e huaja direkte në sektorin e turizmit, duke sjellë në vend marka ndërkombëtare prestigjioze, rritjen e standardeve të shërbimit turistik, gjenerimin e vendeve të reja pune, rritjen e profesionalizmit në sektor përmirësim e standardeve të shërbimit etj, me votat e shumicës së anëtarëve të Komisionit pjesëmarrës në mbledhje e miratoi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, në parim, nen për nen dhe në tërësi me këto ndryshime:

- Në titullin e projektligjit fjala “shtesë” zëvendësohet me fjalën “ndryshim” dhe bëhet “Për një ndryshim në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

- Në nenin 1 të projektligjit bëhen këto ndryshime:
 - Në paragrafin hyrës fjalët “në nenin 27, pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja "ë”,” zëvendësohen me fjalët “në nenin 69, pika 1, shkronja “b” ndryshohet”.
 - Në paragrafin/fjalinë e fundit fjalët “por jo më vonë se 3 vjet” bëhen “por jo më vonë se 5 vjet”.

RELATOR

KRYETAR

Enslemvera ZAKE

Eduard SHALSI